




REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVO

KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE/MUNICIPAL GJILAN/GILAN BELEDIYESI



Adresa: rr. "Adem Jashari" pn, www.gjilani-komuna.org; e-mail: zip_gjilan@hotmail.com, tel. 0280 320 781, 320 782, 321 482, 321 486

Duke u bazuar në nenin 39 të Statutit të Komunës së Gjilanit 01. nr. 12479 të dt. 21.11.2008, si dhe bazuar në Rekomandimin e Komitetit për Politikë dhe Financa të datës 22.03.2011, Kuvendi i Komunës së Gjilanit në mbledhjen e mbajtur me datën 29.03.2011, miratoi këtë:

V E N D I M
KOMPENSIMIN MATERIAL TË FAMILJES SË ISH KRYETARIT TË
KOMUNËS SË GJILANIT

I.

Familjes së ngushtë të ish kryetarit të komunës Xhemajl Hyseni i lejohet një përkujdesje e veçantë materiale në vlerë pre 500 euro në muaj deri sa çështja e pozitës materiale të familjeve të këtyre personaliteteve të rregullohet me ligj apo në ndo një formë tjetër.

II.

Familja e ngushtë e ish kryetarit Xhemajl Hyseni gjithashtu do të ketë një trajtim të veçantë në shërbimet publike komunale duke qenë e liruar nga obligimet financiare për shërbimet e ofruara nga administrata e komunës së Gjilanit si dhe shërbimet e saja në nivel komunal.

III.

Familja e ngushtë do të stimulohet në aspekt të mbështetjes financiare me qëllim që ndonjë nga anëtarët e familjes të mund të shkollohet apo të ngritët në aspekt profesional.

IV.

Ky vendim do të vlejë në mënyrë retroaktive nga 01.01.2011 dhe do të jetë i pandryshueshëm gjatë tërë vitit kalendarik.

V.

Për zbatimin e këtij vendimi duhet të kujdeset kryetari i Komunës Gjilanit, ndërsa për monitorim të zbatimit kujdeset Kryesuesi i KK-Gjilan.

01. Nr. 16/4340
Gjilan, më 29.03.2011

Kuvendi i Komunës.

Izmi Zeka, Kryesues